



Gjuhët
e tjera i gjeni
në: www.kindersitze.tcs.ch




Fëmijët në makinë

Një nga dy fëmijë lidhet në mënyrë të gabuar. Ndhmoni edhe ju ta përmirësojmë këtë gjë!



Sigurojeni fëmijën tuaj në mënyrë të saktë në makinë!

- Çdo vit aksidentohen rreth 400 fëmijë në makinë!
- Një nga dy fëmijë nuk lidhet në mënyrë të saktë në makinë!
Një nga 14 fëmijë nuk lidhet fare!
- Pa ndenjësë fëmijësh fëmija është 3 herë më shumë i rrezikuar që të plagoset rëndë ose të vritet gjatë një aksidenti!



* Në ndenjësët e fëmijëve në përputhje me Normën e re ECE-R129 fëmijët deri 15 muajsh duhet të lidhen në drejtim të kundërt me lëvizjen e automjetit.

Të vegjëlit

- ✓ Montojeni mbajtësen e foshnjës **gjithmonë në drejtim të kundërt me lëvizjen e automjetit.**



- ✓ Mos përdorni kurrë një mbajtëse foshnjeje në ndenjësën e përparme të pasagjerit nëse është aktivizuar airbag-u i përparmë. Në vend të kësaj vendoseni ndenjësën e fëmijës në **ndenjësën e pasme** të automjetit.

- ✓ Ndryshoni vetëm atëherë në grupin tjetër më të madh nëse koka e fëmijës **del mbi mbajtëse**. Në ndenjësët e fëmijëve në përputhje me normën e re ECE-R129 fëmijët deri 15 muajsh duhet të lidhen në drejtim të kundërt me drejtimin e lëvizjes së automjetit.

Të mesmit

- ✓ Sigurohuni që ndenjësja e fëmijës të jetë **fiksuar fort me automjetin** (Kini kujdes nga montimi tepër i lirë!).



- ✓ Tek ndenjësët e fëmijëve me fiksues Isofix (fiksues të normuar): Kontrolloni autorizimin me **listën e tipeve të automjeteve** të ndenjësës së fëmijës.

- ✓ Ndryshoni vetëm atëherë në grupin tjetër më të madh nëse koka e fëmijës **del mbi ndenjësën e fëmijës**.

Të mëdhenjtë

- ✓ Fëmijët deri 12 vjeç ose deri në madhësi trupore 150 cm (në varësi të kushtit që plotësohet i pari) kanë nevojë për **lartësues ndenjësese**, dhe më mirë do të ishte me mbështetëse shpine për më shumë rehati dhe siguri. Një lartësues i thjeshtë ndenjësese është i lejuar por nuk ofron mbrojtje në rastin e përplasjes anësore.



- ✓ Kujdesuni për një mbajtje të saktë dhe të **tendosur të rripit**.

- ✓ Vendet më të sigurta për fëmijët në automjet, edhe për fëmijët më të rritur, janë ato në **ndenjësët e pasme**.

E rëndësishme:

- Në vendet me rrip sigurimi me 3 pika fiksimi, për fëmijët nën 12 vjeç, të cilët janë më të shkurtër se 150 cm, duhet të përdoret një mekanizëm i përshatshëm mbajtjeje fëmijësh (p.sh. lartësues ndenjësese me ose pa mbështetëse shpine) (në përputhje me Art. 3a VRV).
- Ndenjësja e fëmijës duhet të jetë certifikuar në përputhje me ECE-R44/03 resp. 04 ose R129 (në shumicën e rasteve etiketë portokalli).
- Këqyrni manualin e përdorimit për ndenjësën e fëmijës si dhe për automjetin.
- Rripi duhet të qëndrojë sa më ngushtë të jetë e mundur në trupin e fëmijës (palltot dimërore duhet të hiqen ose të hapen, përndryshe efekti mbrojtës reduktohet).

Ndenjësët e fëmijëve shpëtojnë jetë - por vetëm nëse përdoren në mënyrë të saktë!